



USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 7 (827705)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 12 Shkurt 2021

Forumi aktualisht ishte nën kryesimin e SHBA



Gjeneralmajor Bajram Begaj në seminarin e nivelit të lartë të OSBE mbi doktrinat ushtarake

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj mori pjesë në seminarin 2 ditor të nivelit të lartë mbi doktrinat ushtarake të organizuar nga Forumi për Siguri dhe Bashkëpunim i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), forum i cili aktualisht është nën kryesimin e

SHBA. Në seminar u trajtuan çështje që lidhen me situatën e sigurisë në zonën evropiane dhe vlerësimin e trendeve operacionale, shkurajimin nëpërmjet forcës konvencionale, garën strategjike brenda kufirit të konfliktit të armatosur, bashkëpunimin midis shteteve, si dhe rolin e forcave të armatosura... >>> faqe 2

Emërohen dy komandantë të rinj në strukturat e FT

Nënkolonel Nebiaj në Batalionin e Mbështetjes dhe kolonel Dauti në Qendrën Stërvitore



>>> faqe 5

Gjeneralmajor Bajram Begaj takon Gjeneral Major Joseph Jarrard Stërvitja "Defender Europe 21" do të zhvillohet nga data 1 maj deri më 14 qershor 2021

Paketa e stërvitjes drejtohet nga Komanda e Forcave Tokësore Amerikane (US ARMY EUR) dhe përbëhet nga katër stërvitje kryesore të ushtrisë së SHBA, të cilat do të zhvillohen njëkohësisht të bashkërenduara me njëra-tjetrën dhe me stërvitje të tjera të NATO-s >>> faqe 3



Përmbytjet në Shkodër e Lezhë

Haki Çako: Fermerët e dëmtuar do të dëmshpërblehen sipas ligjit

Drejtor i Emergjencave Civile, Haki Çako u shpreh në "Euronews Albania" më 3 shkurt, se ende në qarqet Shkodër dhe Lezhë ka zona të përmbytura. "Tashmë fillon faza e rehabilitimit dhe përmirësimit të të gjithë sipërfaqeve të mbuluara me ujë. Ka filluar rënia e nivelit të ujërave, edhe në ambiente ku ka banesa, kryesisht në zonën e NënShkodrës", u shpreh zoti Çako. Sa i përket furnizimit...



>>> faqe 4

Rëndohet situata e reshjeve në Shkodër

Forcat e Armatosura nisin evakuimet e banorëve dhe bagëtive

Reshjet e dendura kanë sjellë, dje, ditën e enjte përkeqësim të situatës së përmbytjeve në bashkinë e Shkodrës. Forcat e Armatosura kanë shtuar praninë në terren për t'i ardhur në ndihmë banorëve të prekur dhe pushtetit lokal për të përballuar situatën. Trupat dhe mjetet e Batalionit të I-rë të Këmbësorisë së Vaut të Dejës (b1k) evakuuan 10 familje... >>> faqe 5



JENS STOLTENBERG - DENYS SHMYHAL

NATO jep mbështetje të plotë për Ukrainën

MSC. MIMOZA GOLIKJA

>>> faqe 8

RIJETËSIMI I BAZËS AJRORE TË KUÇOVËS

Baza do të ketë sërish shkëlqimin e dikurshëm si pjesë e rëndësishme e Forcave Ajrore të Shqipërisë >>> faqe 6

QPR KËRKON KANDIDATË

Dy të drejta studimi: Akademia "Modena" dhe Akademia "Livorno"-Itali >>> faqe 7

Forumi aktualisht ishte nën kryesimin e SHBA

Gjeneralmajor Bajram Begaj në seminarin e nivelit të lartë të OSBE mbi doktrinat ushtarake

Për vitin 2021 seminari u zhvillua virtualisht nëpërmjet platformës online në kuadër të zbatimit të masave ndaj pandemisë COVID-19 duke sjellë së bashku rreth 350 ushtarakë dhe ekspertë të nivelit të lartë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj mori pjesë në seminarin 2 ditor të nivelit të lartë mbi doktrinat ushtarake të organizuar nga Forumi për Siguri dhe Bashkëpunim i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), forum i cili aktualisht është nën kryesimin e SHBA.

Në seminar u trajtuan çështje që lidhen me situatën e sigurisë në zonën evropiane dhe vlerësimin e trendeve operacionale, shkurrësimin nëpërmjet forcës konvencionale, garën strategjike brenda kufirit të konfliktit të armatosur, bashkëpunimin midis shteteve, si dhe rolin e forcave të armatosura në përgjigje ndaj krizave duke analizuar edhe impaktin e pandemisë në zhvillimin e doktrinës ushtarake.

Në fjalën e tij gjatë seminarit, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj nënvizoi faktin se edhe pse ka një trend pozitiv në zonën evropiane si integrimi, bashkëpunimi dhe përpjekjet e përbashkëta për paqe, liri, siguri dhe drejtësi, përsëri situata e sigurisë aktuale përballat me sfida dhe kërcënime që tejkalojnë natyrën tradicionale dhe kërkojnë një bashkëpunim ndërkombëtar.

Pandemia e COVID-19 ka sjellë një tjetër dimension në mënyrën se si Forcat e Armatosura do të përballen me sfidat dhe rreziqet ndaj sigurisë.

Gjithashtu, gjeneralmajor Begaj konfirmoi se OSBE mbetet një platformë kyçe për nxitjen e dialogut, transparencës dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet shteteve, duke kontribuar kështu në sigurinë e rajonit.

Në përfundim, pjesëmarrësit në seminar ranë dakord që takime të tilla të nivelit të lartë i shërbejnë rritjes së bashkëpunimit midis shteteve dhe duhet të intensifikohen në të ardhmen.

Ky aktivitet zhvillohet një herë në pesë vjet dhe ka për qëllim kryesor nxitjen e dialogut dhe shkëmbimin e informacioni midis përfaqësuesve më të lartë ushtarakë të shteteve, duke synuar arritjen e një kuptimi të përbashkët doktrinar mbi sigurinë evropiane si dhe ndërtimin e mirëbesimit të ndërsjellët dhe transparencës së aktiviteteve ushtarake të shteteve.

Për vitin 2021 seminari u zhvillua virtualisht nëpërmjet platformës online në kuadër të zbatimit të masave ndaj pandemisë COVID-19 duke sjellë së bashku rreth 350 ushtarakë dhe ekspertë të nivelit të lartë.



EMERIME NË FORCAT TOKËSORE

Kolonel Arben Zani emërohet komandant i Regjimentit të Operacioneve Speciale

Në ambientet e Batalionit të Forcave Speciale, u organizua më 5 shkurt 2021, ceremonia e prezantimit dhe marrjes së detyrës së komandantit të Regjimentit të Operacioneve Speciale kolonel Arben Zani. Në këtë ceremoni morën pjesë, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, drejtori i Personelit në SHPPFA kolonel Leonard Çoku, efektiv i Shtabit të Forcës Tokësore dhe komandantët e reparteve vartëse.

Ceremonia filloi me leximin e urdhrat të emërimit në detyrë të kolonel Arben Zani nga shefi i Personelit të Forcës Tokësore nënkolonel Dhimitër Selmanaj. Prezantimi i kolonel Zani, në detyrën e re, u krye nga komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, i cili në fjalën e tij të rastit, e vlerësoi kolonel Zanin, si një kolonel që i përket spektrit të oficerëve profesionistë, të disiplinuar dhe me ndjenjë të lartë përgjegjësie. Këto cilësi sipas gjeneral brigade Kingjit kanë shoqëruar kolonel Zanin në çdo detyrë që ai ka kryer gjatë karrierës së tij, duke filluar që nga pozicioni i komandantit të togës dhe deri tek detyra e tij më e fundit.

Nga ana e tij komandanti i Regjimentit të Operacioneve Speciale të Forcës Tokësore falënderoi ministrin e Mbrojtjes, shefin e Shtabit të Përgjithshëm si dhe komandantin e Forcës Tokësore për besimin që kanë treguar



me emërimin e tij në një strukturë të rëndësishme për FA siç është Regjimenti i Operacioneve Speciale. Ai garantoj se do të jetë gjithmonë në krye të punës dhe sfidave që koha do të sjellë për këtë

njësi të sapo krijuar por dhe për Forcën Tokësore në tërësi. Kjo ceremoni u mbyll me një foto të përbashkët për të memorizuar këtë moment historik të riorganizimit të Forcës Tokësore.

Gjeneralmajor Bajram Begaj takon Gjeneral Major Joseph Jarrard

Stërvitja "Defender Europe 21" do të zhvillohet nga data 1 maj deri më 14 qershor 2021

Paketa e stërvitjes drejtohet nga Komanda e Forcave Tokësore Amerikane (US ARMY EUR) dhe përbëhet nga katër stërvitje kryesore të ushtrisë së SHBA, të cilat do të zhvillohen njëkohësisht të bashkërenduara me njëra-tjetrën dhe me stërvitje të tjera të NATO-s

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, priti më 3 shkurt 2021, në takime pune Gjeneral Major Joseph Jarrard, zëvendëskomandant i Përgjithshëm i Forcave Tokësore Amerikane në Evropë dhe Afrikë, në kuadër të zhvillimit në vendin tonë të stërvitjes "Defender Europe 21" e cila që nga viti 1995, konsiderohet si një nga më të mëdhatë në Europë.

"Defender Europe 21", e cila do të zhvillohet nga data 1 maj deri më 14 qershor 2021, është stërvitja shumëkombëshe më e madhe, e zhvilluar ndonjëherë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në rajonin tonë, në tre dekadat e fundit, si për forcat pjesëmarrëse dhe mjetet e dislokuara, ashtu dhe për forcat dhe mjetet që do të kryejnë kalimin transit në vendin tonë.

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë do të demonstrojnë kapacitetet e vendit pritës, koordinuese dhe mbështetëse, të një stërvitje në shkallë të gjerë dhe komplekse, si dhe trajnimi për të gjithë komponentët dhe shërbimet, në stërvitje të përbashkëta dhe rajone të ndryshme.

Përmirësimi e ndërveprueshmërisë dhe rritja e besueshmërisë së aleatëve tek kapacitetet, përgatitja dhe procedurat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për të operuar së bashku me forcat e vendeve të tjera të NATO s apo edhe midis forcave të ndryshme janë objektivat tonë operacionale, shprehu gjeneralmajor prof. asoc. Begaj. Më tej ai theksoi se "Forcat tona janë të mirëstërvitura dhe të pajisura me armatim dhe mjete bashkëkohore, për të ndërvepruar krah për krah me forcat ushtarake amerikane dhe vendeve të tjera aleate".

Ndërsa, gjeneralmajor Jarrard vlerësoi partneritetin dhe bashkëpunimin ushtarak me FARSH-in, dhe falënderoi SHSHP të FA për mbështetjen e dhënë për zhvillimin me sukses të kësaj stërvitje në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Stërvitja do të shërbejë si platformë për përgatitjen dhe certifikimin e kapaciteteve operacionale (reparteve) të deklaruara në NATO, në kuadër të një operacioni shkuraues për përballimin e një rreziku/kundërshtari të përbashkët. Risi e kësaj stërvitje do të jetë përfshirja e Qendrës së Kontroll Raportimit të Forcës Ajrore në Sistemin e Komandim Kontrollit të operacioneve ajrore.

Paketa e stërvitjes drejtohet nga Komanda e Forcave Tokësore Amerikane (US ARMY EUR) dhe përbëhet nga katër stërvitje kryesore të ushtrisë së SHBA, të cilat do të zhvillohen njëkohësisht të bashkërenduara me njëra - tjetrën dhe me stërvitje të tjera të NATO.

SHSHP i FA gjithashtu vuri theksin te sfida e zhvillimit të stërvitjes gjatë situatës së pandemisë globale, e cila do të dëshmojë se ne jemi në gjendje të ruajmë gatishmërinë operacionale dhe përmbushim misionin tonë kushtetues edhe në këto situata. Ai siguroi bashkëfolësin për zbatimin e protokolleve shëndetësore për parandalimin e përhapjes së virusit "COVID 19", kujdesi shëndetësor ndaj personelit pjesëmarrës në stërvitje, si edhe popullsisë në rajonet stërvitore është dhe do të jetë prioritet.

Gjatë vizitës dyditore në Tiranë, gjeneralmajor Jarrard pati takime me autoritet më të larta të komandimit dhe drejtimit të FA, si dhe me disa autoritete të institucioneve kryesore të



sigurisë së vendit dhe të politikës.

Gjeneral Majori Joseph Jarrard është me prejardhje nga Dahlonga, Georgia-SHBA. Ai mori detyrat e tij si zëvendëskomandant i Përgjithshëm i Forcave Tokësore Amerikane në Evropë dhe Afrikë, më 1 Prill 2019. Gjeneral Majori Jarrard u diplomua

nga Kolegji North Georgia-SHBA në vitin 1988. I emëruar nga guvernatori i Shtetit të Gjeorgjisë në 2014, Gjeneral Majori Jarrard shërbeu si Adjutant i Përgjithshëm i 42-të i Georgisë. Më parë ai shërbeu tre vjet si ndihmës gjeneral dhe gjeneral komandues i Gardës Kombëtare të Ushtrisë Georgia. Nën drejtimin e tij, Garda Kombëtare

e Ushtrisë së Gjeorgjisë u zgjodh nga Komanda e Forcave të Ushtrisë Amerikane për të drejtuar rrugën në zbatimin e Programit të Njësisë së Asociuar të Ushtrisë. Skuadra luftarake e Brigadës së 48-të të Këmbësorisë të Georgia është në linjë direkt me Divizionin e 3-të të Këmbësorisë. Ai ka qënë në Irak në mbështetje të Operacionit Irak-Liria

në vitet 2003 dhe 2005. Ai gjithashtu punoi si kontraktor i mbrojtjes në Afganistan nga muaji prill 2010 deri në shtator 2011. Çmimet dhe dekoratat e tij përfshijnë "Legjioni i Meritës", "Yllin e Bronzit", medalja "Shërbimi Meritor", etj. Gjeneral Majori Jarrard është i martuar me Susan, dhe kanë tre djem, Ben, Will dhe Joseph.



QENDRA STËRVITORE E FORCËS TOKËSORE

Kurse institucionale të oficerit në specialitetet Këmbësori dhe Zbulim

Kursi Bazë i Oficerit është një nga kurset më të gjata që zhvillohen në Qendrën Stërvitore dhe zgjat 18 javë

Në mjediset e Qendrës Stërvitore të Forcës Tokësore po zhvillohen kurset institucionale të oficerit në specialitetet Këmbësori dhe Zbulim, si dhe Kursi Bazë dhe i Avancuar i Nënoficerit. Kursi Bazë dhe Kursi i Avancuar i Nënoficerit, që kanë filluar në datën 25 janar 2021 kanë një program të shtrirë në një periudhë 8-javore. Në këto kurse zhvillohen temat mësimore në module teorike dhe praktike. Qëllimi i kurseve është përgatitja e nënoficerit për drejtimin e trupave në nivel skuadër dhe togë këmbësorie. Kursi Bazë i Oficerit është një nga kurset më të gjata që zhvillohen në Qendrën Stërvitore dhe zgjat 18 javë. Në këtë kurs trajtohen temat e lidershit ushtarak, taktikë, alpinizëm, përgatitje fizike dhe zbulim. Qëllimi i Kursit Bazë të Oficerit është përgatitja e oficerit në rolin e komandantit të togës. Kurset institucionale shërbejnë për formimin ushtarak si dhe janë të rëndësishme pasi janë në funksion të marrjes së të gradës së radhës.



Përmytjet në Shkodër e Lezhë

Haki Çako: Farmerët e dëmtuar
do të dëmshpërblehen sipas ligjit*Shkodra dhe Lezha janë dy prej qarqeve, të cilat
po vuajnë më shumë pasojat e reshjeve të ditëve të fundit*

Drejtor i Emergjencave Civile, Haki Çako u shpreh në “Euronews Albania” më 3 shkurt, se ende në qarqet Shkodër dhe Lezhë ka zona të përmytura. “Tashmë fillon faza e rehabilitimit dhe përmirësimit të të gjithë sipërfaqeve të mbuluara me ujë. Ka filluar rënia e nivelit të ujërave, edhe në ambiente ku ka banesa, kryesisht në zonën e NënShkodrës”, u shpreh zoti Çako.

Sa i përket furnizimit me ushqim për bagëtitë ai nënvizoi se “nuk ka pasur mungesë të bazës ushqimore në të gjithë zonën, kryesisht në atë të Shkodrës”. Për çështjen e dëmshpërblimeve, kreu i Emergjencave Civile tha se prezenca e ujit e ka bërë të vështirë vlerësimin e dëmeve në terren.

Por, zoti Çako deklaroi se kompesinimi i fermerëve apo banorëve do të bëhet sipas ligjit. “Ju siguroj që vlerësimi është maskimal, do të merren në konsideratë të gjitha kapacitetet dhe hapësirat që parashikon ligji dhe të gjitha hapësirat që ka adresuar qeveria shqiptare në buxhetet e njësive të pushtet vendor, por edhe kapacitete të tjera”, përfundoi zoti Çako. Shkodra dhe Lezha janë dy prej qarqeve, të cilat po vijnë pasojat e reshjeve të ditëve të fundit.



STRUKTURAT E KOMANDËS MBËSHTETËSE

Angazhim në ndihmë të banorëve
për përballimin e përmytjeve

Strukturat e Komandës Mbështetëse kanë vënë në gatishmëri të gjitha kapacitetet operacionale me mjete dhe forca për përballimin e situatës së krijuar gjatë këtyre ditëve, në operacionin në ndihmë të popullsisë në zonat e përmytura për shkak të reshjeve të dendura të shiut.

Efektivët e strukturave të Komandës Mbështetëse kryesisht është angazhuar në kryerjen e evakuimit të popullsisë, si dhe shpërndarjen e pakove ushqimore për banorët e Obotit në Shkodër të cilët janë të izoluar nga niveli i lartë i ujit situatë kjo e krijuar për shkak të reshjeve.

Me një nga varkat e batalionit të BMR është bërë evakuimi i një fëmije të sëmurë për në poliklinikë më pas drejt spitalit, e cila jetonte në një nga shtëpitë e izoluar nga uji prej ditësh Efektivët e Komandës Mbështetëse ndodhen në gatishmëri për t’u përgjigjur çdo situatë të krijuar nga reshjet.

Por gjatë ditës së enjte, më 11 shkurt, reshjet gjatë 24 orëve krijuan probleme të shumta në qytetin e Shkodrës. Prurjet në lu-



menj kanë qenë të mëdha aq sa lumi Buna ka dalë nga shtrati dhe niveli i liqenit të Shkodrës u rrit ndjeshëm duke shkaktuar përmytje të disa rrugëve të qytetit si në Livadhe, Xhabije, Tophanë, Zotënikë, Tepe, Perash ku janë evakuuar nga shtëpitë

e tyre në qytet mbi dhjetë familje tek të afërmit e tyre dhe në strehime të tjera dhe forcat ushtarake kanë punuar për largimin e ujit nga shtëpitë të cilat kanë patur prezencë uji në oborre, duke parandaluar dëmtimin e disa banesave.

Gjeneral brigade Ndrëçim Sallaku

Komanda Mbështetëse:
Angazhim në mbështetje
të popullsisë në nevojë

Në ambientet e Komandës Mbështetëse gjeneral brigade Ndrëçim Sallaku priti në një takim prefektin e Tiranës z. Toni Gogu me të cilin diskutuan mbi angazhimet e strukturave të KM për përballimin e emergjencave civile gjatë kësaj periudhe. Gjeneral brigade Sallaku e njohu prefektin me impenjimet e shumta e në disa drejtime të KM në mbështetje të popullsisë në nevojë për evakuimin e njerëzve të bllokuar nga përmytjet, hapjen e rrugëve të bllokuara nga dëborat, heqjen e masivëve shkëmborë rënë si pasojë e rrëshqitjeve të dheut etj. Në përfundim, gjeneral brigade Sallaku së bashku me prefektin e Tiranës inspektuan nga afër operacionin që po zhvillohet për heqjen e një masivi dhe hapjen e rrugës në fshatin Mënik, njësi administrative Ndroq, Tiranë.

Reshjet e shiut përmytin
rreth 300 ha në Lezhë

Reshjet e shiut me intensitet mesatar dhe të dobëta kanë përfshirë këto ditë edhe Lezhën gjatë orëve të natës dhe mëngjesit e ditës së enjte. Si pasojë e reshjeve të rëna janë përmytur rreth 300 ha, sipërfaqe të tokës bujqësore në zonat e ish-këneten Torovicë, Balldre, etj. ku sasia e reshjeve të rëna ishte rreth 40 mm. Hidrovoret janë në punë me kapacitet të plotë për evadimin e ujërave, konkretisht niveli i ujit është në rreth 10-35 cm mbi kuotat normale, kanalet e ujërave të larta ato të dyta dhe të treta, ishin rreth 25-45 cm mbi kuotat normale. Duhet thënë se rezervuarët, ishin në monitorim, veprat e marrjes ishin të hapura për shkarkimin, furnizimi me energji elektrike dhe ujë të pijshëm ishte normal, rrugët nacionale, rurale e bashkiake në tërësi janë të kalueshme, por problem paraqet rruga rurale Rrëshen-Bukmirë, sepse ka pasur rrëshqitje të dherave dhe ulje të shtratit të rrugës, duke vështirësuar lëvizjen e mjeteve.

Rëndohet situatë e reshjeve në Shkodër

Forcat e Armatosura nisin evakuimet e banorëve dhe bagëtive

BMR ka angazhuar në bashkinë e Shkodrës 7 mjete lundruese, të cilat mundësojnë lëvizjen e banorëve dhe janë në gatishmëri për çdo evakuim të mundshëm

Reshjet e dendura kanë sjellë, dje, ditën e enjte përkeqësim të situatës së përmbytjeve në bashkinë e Shkodrës. Forcat e Armatosura kanë shtuar praninë në terren për t'i ardhur në ndihmë banorëve të prekur dhe pushtetit lokal për të përballuar situatën.

Trupat dhe mjetet e Batalionit të I-rë të Këmbësorisë së Vaut të Dejës (b1k) evakuuan 10 familje në lagjen "Iliria" të qytetit të Shkodrës, të cilat u transportuan për t'u strehuar në konviktin e Universitetit "Luigj Gurakuqi".

Gjithashtu, trupat dhe mjetet e Batalionit të I-rë të Këmbësorisë së Vaut të Dejës (b1k) evakuuan rreth 150 krerë bagëti e imët nga lagjja e njohur si Livadhet pranë bregut të liqenit në qytetin e Shkodrës.

Në njësinë administrative Dajç, trupat dhe mjetet e b1k evakuuan rreth 2000 shpendë nga një fermë private, për t'i dërguar në fshatin Shirq.

Në fshatin Obot të njësisë administrative Ana e Malit vijon transporti i banorëve për nevojat e tyre të përditshme nëpërmjet mjeteve lundruese të batalionit të mbështetjes rajonale (BMR) dhe mjeteve të kalueshmërisë së lartë të b1k.

BMR ka angazhuar në bashkinë e Shkodrës 7 mjete lundruese, të cilat mundësojnë lëvizjen e banorëve dhe janë në gatishmëri për çdo evakuim të mundshëm.

Zëvendësministri i Mbrojtjes Petro Koçi, i shoqëruar nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Emergjencave Civile Haki Çako dhe prefektja e qarkut Majlinda Angoni po ndjekin situatën në zonat e përmbytura në bash-



kinë e Shkodrës. Në gjithë qarkun e Shkodrës janë 5030 ha sipërfaqe totale e përmbytur, ndërkohë që ka prani të ujit në disa banesa në lagjet e qytetit dhe në njësitë Ana e Malit dhe

Dajç. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në bashkëpunim me pushtetin vendor po monitoron situatën dhe po koordinon punën për përballimin sa më të mirë të gjendjes së shkaktuar.

Ushtria ka evakuuar 10 familje në lagjet e Shkodrës

Prefektja e qarkut të Shkodrës, Majlinda Angoni, tha dje se "jemi në terren me një grup pune të inxhinierëve dhe specialistëve si dhe me drejtorin e Emergjencave Civile Haki Çako në zonën e Dajçit". "Po inspektojmë situatën dhe po vlerësojmë hap pas hapi nevojën e emergjencës. Janë të gjitha strukturat e ushtrisë dhe të shëndetësisë në gatishmëri për t'iu përgjigjur nevojave të banorëve qoftë me transport, apo për problematika që mund të kenë në aspektin shëndetësor", tha Angoni.

Prefektja Angoni u shpreh se "nuk kemi asnjë shtëpi të përmbytur në Dajç, por kemi prezencë uji në shtëpi dhe ka një rritje të nivelit të ujit për shkak edhe të prurjeve të lumenjve Gjadër dhe Kir". Përsa i takon raportimeve nga Kaskada e Drinit, Angoni tha se "tani janë ulur shkarkimet me 400 m3 në sekondë, pavarësisht se prurjet natyrore janë mbi 2 mijë m3 në sekondë. Hidrocentrali po bën maksimumin që të mos ndikojë në këtë moment në zonën e Nënshkodrës". Sipas saj, lagjet më problematike kanë qenë ato periferike të Shkodrës, pasi ka dalë Buna nga shtrati në një pjesë. "Deri tani kemi 10 familje që janë evakuuar në lagjet e Shkodrës, pasi ky qytet është më problematik tani sesa zona e Nënshkodrës", tha Angoni



Emërohen dy komandantë të rinj në strukturat e Forcës Tokësore

Nënkolonel Nebiaj në Batalionin e Mbështetjes dhe kolonel Dauti në Qendrën Stërvitore

Në ambientet e Komandës së Forcës Tokësore, u zhvillua më 8 shkurt 2021, ceremonia e marrjes së detyrës së komandantit të Batalionit të Mbështetjes me Shërbime të Forcës Tokësore, nënkolonel Manush Nebiaj.

Në ceremoni mori pjesë, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, Shefi i Shtabit kolonel Ilirjan Dauti, përfaqësues nga Shtabi i Forcës Tokësore dhe pjesëtarë të këtij reparti. Ceremonia filloi me leximin e urdhrit të emërimit në detyrë të nënkolonel Manush Nebiaj nga shefit të Personelit të Forcës Tokësore nënkolonel Dhimitër Selmanaj.

Batalioni i Mbështetjes me Shërbime është një nga dy strukturat më të reja të krijuara në Forcën Tokësore, dhe si e tillë prezantimi i nënkolonel Nebiaj, në detyrën e re, u krye nga Komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, i cili në fjalën e tij të rastit, e vlerësoi nënkolonel Nebiaj, si një nënkolonel me përvojë të gjatë ushtarake, të disiplinuar dhe me ndjenjë të lartë përgjegjësie. "Jam besim plotë që nënkolonel Nebiaj do e kryej këtë detyrë me përsosmëri pasi ka një eksperiencë të gjatë në këtë drejtim." - tha ndër të tjera gjeneral Kingji.

Nga ana e tij komandanti i batalionit të Mbështetjes me Shërbime të Forcës Tokësore falenderoi Komandantin e Forcës Tokësore për besimin që e treguar me emërimin e tij në këtë strukturë të re të Forcës Tokësore dhe i siguroi se kjo njësi e re, nga sot, do të flasë vetëm me punë. Gjithashtu në ambjentet e Qendrës Stërvitore, u zhvillua një tjetër ceremoni për marrjen e detyrës nga komandanti i ri, kolonel Ekland Dauti.

Edhe kjo ceremoni u përshëndet nga komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji i cili falenderoi punën e palodhur të komandantit pararendës kolonel David Rroku. "Qendra Stërvitore është një



nga repartet më të kompletuara dhe me ambjentet më bashkëkohore. Kjo falë punës Tuaj të palodhur dhe padyshim falë mbështetjes së pandërprerë të Shtabit të Përgjithshëm dhe Ministrisë së Mbrojtjes." - u shpreh gjeneral Kingji. Komandanti i sapoemëruar i Qendrës Stërvitore, kolonel

Ekland Dauti vjen nga një rrugëtim i gjatë në karrierën ushtarake. Ai ka ushtuar detyra si komandant në batalionin e Forcave Speciale dhe Policin Ushtarake, zëvendës komandant i kësaj Qendre dhe së fundmi Shef i Operacioneve në Forcën Tokësore.

HAJRIE DEDAJ

Situata do të merrte një kthesë tjetër për Bazën Ajrore të Kuçovës, kur Aleanca e Atlantikut të Veriut miratoi vendimin për të ndërtuar në Shqipëri bazën e parë ajrore në Ballkanin Perëndimor. Prej vitesh tashmë në këtë aerodrom mungonte zhurma e motorëve të avionëve, në pistat e aerodromit mbizotëronte qetësia. Avionët e fjetur meritonin të zgjoheshin, ajo bazë ajrore meritonte të kishte sërish shkëlqimin e dikurshëm si pjesë e rëndësishme e Forcave Ajrore të Shqipërisë. Kjo bazë ajrore ishte shpirti i qytetit, një shpirt që do të mund të frymojë sërish në tetor të këtij viti kur në bazë të fillojnë punimet për rimëkëmbjen e saj. Aerodromi ka një pistë, e cila ka një infrastrukturë të kohës dhe mund të përballojë dhe punime të tjera. Aktualisht paralel me pistën funksionale, ndodhet pista e vjetër e aviacionit e krijuar qysh më 1939 nga italianët, ky ishte dhe momenti i fillimit të aerodromit të Kuçovës. Pas luftës nuk ka pasur aktivitet deri në 5 maj të 1955 datë e cila shënon dhe inaugurimin si baza e parë ajrore e Aviacionit Luftarak Shqiptar. Në këtë aerodrom kanë qëndruar avionë të tipit JAK, MIG-15, MIG-17, MIG-19, avionë reaktiv kinez e sovjetik, avionë luftarak, avionë flote, por asnjë prej MIG-ve nuk fluturon më prej vitesh. Ne vitin 2004 qeveria vendosi të ndalonte fluturimin e tyre për shkak të një aksidenti që i mori jetën një piloti, Jani Tarifës. Këto pajisje luftarake prej shumë vitesh janë relike dhe dëshmi e asaj çka ishte para shumë vitesh baza ajrore e Kuçovës e cila së bashku me Uzinën e Riparimit të Avionëve ishte një pjesë e rëndësishme e ushtrisë shqiptare, por dhe krenari e vendit. Tashmë të heshtur dhe ashtu të rreshtuar njeri pas tjetrit, mbretërit e qiellit mezi e presin rikthimin.

Për vite me radhë kjo bazë ka qenë shkolla praktike e fluturimeve luftarake për të gjithë pilotët, specialistet, apo inxhinierët e avionëve aktive të diplomuar nga shkolla e aviacionit. Në vitin 2001, me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, në strukturën e re organizative të Forcave Ajrore, ky repart kalon në Akademia e Forcave Ajrore, duke pasur në vartësi dhe Fakultetin Teoriko-Mësimor në Vlorë. Në 2005 mori emrin Shkolla e Trupës së Forcave Ajrore dhe në 2008 kaloi në varësi të KDS-së. Jo pa arsye do të zgjidhej pikërisht kjo bazë në Shqipëri, pasi fusha është e pozicionuar në një vend shumë strategjik, ka kushte atmosferike shumë të mira ku mund të ulen lehtësisht avionët. Qyteti i Kuçovës me realizimin e këtij projekti do të ketë shkëlqimin e dikurshëm, pasi përveçse është një qytet, që lundron në pasuri tokësore si nafta do të ketë sërish bazën e saj ajrore të munguar prej kohësh. Aerodromi do të flegjë dhe zgjohet përsëri në zhurmën e avionëve. Siç duket pas kësaj ngjarje të rëndësishme avionët do të lënë sërish “Gjurmë në kaltërsi” njësoj si filmi me po të njëjtin titull, i cili është realizuar kohë më parë në 1981 në këtë bazë ajrore. Baza Ajrore e Kuçovës përfaqëson një mundësi të shkëlqyeshme për të përmirësuar kontrollin e strukturave të mëdha hapësinore. Kjo bazë që do të ketë mundësinë të presë aeroplanë luftarakë, që kontrollojnë



Rijetësimi i Bazës Ajrore të Kuçovës

Baza do të ketë sërish shkëlqimin e dikurshëm si pjesë e rëndësishme e Forcave Ajrore të Shqipërisë

Investimi në bazë do të jetë projekti më i rëndësishëm i viteve të fundit, jo vetëm për infrastrukturën dhe kapacitetet e modernizuara, por edhe, sepse do të rrisi peshën strategjike të vendit tonë në rajon



hapësirën ushtarakisht dhe kjo do të jetë një risi, e cila do të realizohet fal investimit, që NATO do të bëjë. Detyra momentale e kësaj baze është që të bashkëveprojë me strukturat e FA-së të sigurojë mbështetjen ajrore në përputhje me misionin. Rajonet e dislokimit të bazave ushtarake të NATO-s, të kundërshtojnë në botë, vlerësohen edhe si asete zhvillimi ekonomik të rajonit, pra rajoni ynë do ta ketë privilegjin që të përfitojë nga ndërtimi, mbajtja dhe zhvillimi infrastrukturor i bazës. Investimet për modernizimin e saj do të përfshijnë edhe investime për rregullimin infrastrukturor përreth bazës, pra investimet nuk do të jenë vetëm brenda, por dhe në rrugët nacionale të bazës me të tjera objekte dislokimi apo mirëmbajtje/logjistikë që kërkohen për

të realizuar misionin. Baza e Kuçovës normalisht do të kërkojë edhe objekte të tjera rezervë si aerodrom, paraprakisht prioritet nën kujdesin e NATO-s. Baza ajrore shtrihet në gjatësi dhe gjerësi në rajonin Berat-Kuçovë, e baraslarguar nga dy hapësirat e qyteteve, kështu përfitimet ekonomike do të shtrihen në dy qytetet. Ndërtimi i bazës ajrore është, një projekt sa ambicioz, aq edhe i rëndësishëm jo vetëm për sigurinë tonë kombëtare, por mbi të gjitha për sigurinë rajonale. Vetëm disa ditë më parë, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj dhe zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj së bashku me ministrin Peleshi vizituan bazën dhe panë nga afër mjediset ku do të ndërhyhet, për ta shndërruar bazën ajrore të Kuçovës, në

bazën e vetme taktike të dislokueshme të NATO-s në rajon. Ata vlerësuan maksimalisht rëndësinë, që ka për sigurinë e Shqipërisë dhe rajonit ngritja e një baze të tillë në vendin tonë. “Është një projekt shumë i rëndësishëm, në mos më i rëndësishmi i këtyre viteve të fundit, sepse jo vetëm që na jep një infrastrukturë dhe kapacitete të modernizuara në hartën e Aleancës sonë, por rrit edhe peshën strategjike të vendit tonë në rajon dhe më gjerë. Jemi të gjithë të angazhuar dhe në kohë me kalendarin tonë, si me shpronësimet si me ato pjesë të punimeve që i kemi marrë përsipër t’i kryejmë, që nga rrethimi i bazës, rrugët e brendshme, furnizimi me energji elektrike dhe ujë, të cilat janë pjesë e investimit të palës sonë. Kontributi i palës shqiptare shkon

në rreth 10 % të vlerës së përgjithshme të investimit në këtë bazë, e cila me investimin e NATO-s do të kthehet në një bazë taktike të dislokueshme. Punimet synohet të nisin në vjeshtë të këtij viti dhe tani jemi në fazën e procedurave të prokurimit nga Agjencia e Prokurimit e NATO-s. Në fund të marsit pritet të lidhen kontratat me kontraktorët. Ka shumë të interesuar, kontraktorë vendas dhe të huaj, që do të operojnë për të zbatuar projektet. Në planin tonë kalendarik të punimeve në këtë bazë parashikohet nga muaji tetor-nëntor të nisin punimet që do të zgjasin deri në fund të vitit 2023”, u shpreh ministri Peleshi nga baza ajrore e Kuçovës. Investimi prej rreth 50 milionë euro, konsiston në ndërtimin e depove të armatimit dhe të karburantit, stacioneve të armatimit, parkingut të avionëve, stacionit kundër avarive dhe zjarreve, rindërtimin e pistës dhe kullës së kontrollit. Ky do të jetë projekti më i rëndësishëm i viteve të fundit, jo vetëm për infrastrukturën dhe kapacitetet e modernizuara, por edhe, sepse do të rrisi peshën strategjike të vendit tonë në rajon dhe më gjerë. Baza ajrore e Kuçovës do të shërbejë ndër të tjera edhe për dislokimin e avionëve të ndryshëm të NATO-s. Shefi i Shtabit tha se janë në komunikim me strukturat e NATO-s për nisjen e punimeve në këtë bazë ajrore. Prezenca e NATO-s në bazën tonë do të prodhojë më tepër siguri, ekonomi, kulturë, turizëm dhe më tepër demokraci. Baza Ajrore do të perjetojë dhe një herë shkëlqimin e dikurshëm falë Aleancës së Atlantikut të Veriut.

Qendra e Personel Rekrutimit kërkon kandidatë

Dy të drejta studimi: Akademia "Modena" dhe Akademia "Livorno"-Itali

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është 16 shkurt 2021

Qendra e Personel Rekrutimit do të rekrutojë kandidatë për studime në Akademitë Ushtarake të Italisë, 2 (dy) të drejta studimi si më poshtë vijon: Akademinë Ushtarake Modena, 1 (një) kuotë në degën "Karabinieri"; Akademinë Ushtarake Detare, Livorno, 1 (një) kuotë. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është 16 Shkurt 2021.

Kriteret e pranimit të kandidatëve:

Kandidati duhet të jetë shtetas shqiptar; të ketë kryer shkollën e mesme të lartë ose të jetë në vitin e fundit të saj; të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale; të mos jetë në proces gjykimi penal nga gjykata; të mos ketë probleme me deportimin; të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe alkoolit, për të cilat do të paraqesin testet e kryera; të mos jetë person i dyshuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundraligjshme apo kriminale; të jetë në moshë jo më pak se 18 vjeç dhe jo më shumë se 22 vjeç, në ditën e fillimit të vitit akademik (shtator 2021). të mos jetë i martuar. të kenë gjatësinë trupore mbi 165 për meshkujt dhe mbi 160 cm për femrat ; të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurimit; të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor nga NJMUja e FA-së; të ketë rezultuar pa probleme gjatë verifikimit të kushtit të sigurisë të kryer nga strukturat përgjegjëse. të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (sëmundjeve seksualisht të transmetueshme), të mos vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatiche, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor

dhe i lëvizjes) apo të jetë përdorues i lëndëve narkotike; kandidatët që do të aplikojnë për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit të plotësojnë kriterin e notës mesatare të shkollës së mesme, jo më pak se 7 (shtatë).

Kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në rast se: kanë kryer më parë të njëjtin nivel arsimor ushtarak brenda ose jashtë vendit; kanë qenë kontingjent i Forcave të Armatosura për ndjekjen e studimeve ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe nuk i kanë përfunduar studimet. Kandi-

dati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përcaktuara, skualifikohet.

Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët për regjistrim duhet të paraqesin pranë Zyrës së Pranimit Tiranë dokumentacionin e mëposhtëm: Kërkesë me shkrim për ndjekjen e studimeve në Akademitë Ushtarake të Italisë, ku specifikohet dega dhe institucioni arsimor. Formular me të dhënat personale sipas formatit të përcaktuar, Aneksi A. Fotokopje e

noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomë dhe certifikatë e maturës shtetërore) që vërteton përfundimin e arsimit përkatës së bashku me listën e notave. Fotokopje e kartës së identitetit. Fotografia për dokument (4x6), 2 (dy) copë. Fotokopje të pasaportës e vlefshme për jashtë shtetit. Raportin mjekësor i aftë për kryerjen e studimeve të lëshuar nga mjeku i familjes i Qendrës Shëndetësore të vendbanimit, i shoqëruar me një raport shpjegues ku deklarohet se kandidati është i shëndetshëm dhe nuk ka sëmundje kronike, infektive apo të shëndetit mendor dhe nuk është përdorues i

lëndëve narkotike. Analizat e gjakut për Hepatitin B, C, D, HIV/AIDS, sifiliz, grupin e gjakut të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut ose Bankat e Gjakut apo Drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethet ku banojnë, si dhe test për lëndët narkotike nga laboratorët e certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Formular i vetëdeklarimit për gjendjen shëndetësore, të cilët plotësohen pranë Qendrës së Personel Rekrutimit në momentin e dorëzimit të dokumentacionit, sipas Aneksit B.

Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të testimit:

Kerkohet dëshmi penaliteti, vërtetim nga gjykata që nuk është në proces gjyqësor, vërtetim nga prokuroria që nuk është në proces hetimi, vërtetim nga përmbartimi, raportin mjekësor të lëshuar nga Komisioni Mjeko-Ligjor (KML) i Njësisë Mjekësore Ushtarake.

Testimet që do të zhvillohen:

Aplikantët me që studimet zhvillohet në Universitetet Ushtarake Italiane, testimin do ta zhvillojnë në gjuhën italiane (Italisht) më 17.02.2021, testimi fizik do të zhvillohet më 17.02.2021, testi intelektual do të zhvillohet më 18.02.2021 dhe testi psikologjik do të zhvillohet më 18.02.2021



MSC. MIMOZA GOLIKJA

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg priti në një takim Kryeministrin ukrainas Denys Shmyhal në Selinë e NATO-s më 9 shkurt 2021, ku falënderoi Ukrainën për kontributin e saj të rëndësishëm në misionet dhe operacionet e NATO-s dhe theksoi se statusi i vendit si një partner i mundësive të zgjeruara do të thellojë bashkëpunimin NATO-Ukrainë. Stoltenberg nënvizoi se NATO dhe Ukraina kanë mbështetur njëra-tjetrën gjatë gjithë pandemisë COVID-19. “Qendra e ndihmës së fatkeqësive të NATO-s ka koordinuar shpërndarjen e ndihmës mjekësore në Ukrainë dhe aleatët kanë caktuar avionë ukrainas për pajisjet e ngritjes ajrore për t’iu kundërvënë pandemisë”, tha ai. Stoltenberg shtoi se Fondi i Mirëbesimit të Përgjigjes Pandemike të NATO-s do të përdoret për të ofruar furnizime mjekësore kritike në Ukrainë, duke përfshirë përqendrues të lëvizshëm të oksigjenit, njësi të lëvizshme të rrezeve X dhe pajisje mbrojtëse personale dhe se një sasi e madhe dezinfektantësh do të dorëzohet gjithashtu javën e ardhshme. Sekretari i Përgjithshëm dhe Kryeministri diskutuan gjithashtu situatën e sigurisë në Ukrainë dhe rajonin e Detit të Zi. Stoltenberg riafirmoi mbështetjen e plotë të NATO-s për integritetin territorial dhe sovranitetin e Ukrainës, duke vënë në dukje se NATO ka rritur praninë e saj në rajonin e Detit të Zi. “Vetëm disa ditë më parë, shkatërruesi i Marinës Amerikane USS Porter u trajnuar me anijet e Ukrainës në Detin e Zi dhe avionët spanjollë aktualisht po kryejnë policinë ajrore të NATO-s në rajon”, tha ai. Sekretari i Përgjithshëm përshëndeti gjithashtu përpjekjet e Ukrainës për të zbatuar reforma të mëdha, të cilat mbështesin aspiratat e saj Euro-Atlantike.

Ukraina Partnere e Mundësive të Rritura për NATO-n

Ministrja e Mbrojtjes, Olivera Injac, u takua me Ambasadorin e Republikës së Turqisë në Mal të Zi, Songul Ozan, si dhe të dërguarin e sapoemëruar ushtarak të Republikës së Turqisë për Malin e Zi, kolonel Muhamed Kablaj, i cili gjithashtu bëri një vizitë inauguruese në Ministria e Mbrojtjes. Ministri shprehu kënaqësinë me takimin dhe bashkëpunimin afatgjatë të suksesshëm midis Ministrive të Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë dhe Malit të Zi, të cilat u intensifikuan më tej pas pranimi të vendit tonë në NATO.

Injac përgëzoi kolonel Kablaj për detyrën e tij të re, duke shprehur prijeten që angazhimi i tij do të japë një kontribut shtesë në përmirësimin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes midis dy vendeve. Ministri theksoi rëndësinë e intensifikimit të bashkëpunimit midis dy vendeve në fushën e industrisë së mbrojtjes, duke pasur parasysh se Mali i Zi ka zgjedhur investime të vazhdueshme në sistemin e mbrojtjes, me qëllim forcimin e ndërveprimit të forcave të tij dhe përgjigjen e duhur ndaj sigurisë moderne sfidat.

Ambasadori Ozan përgëzoi Ministrin Injac për emërimin e saj si Ministër i Mbrojtjes dhe vuri në dukje rezultatet që Mali i Zi ka arritur në integrimin evropian, duke theksuar se Republika e Turqisë do të mbetet e përkushtuar për bashkëpunim intensiv midis dy vendeve në të gjitha fushat me interes të përbashkët. Kolonel Kablaj vuri në dukje rezultatet që Mali i Zi ka arritur në reformën e sistemit të



mbrojtjes, duke theksuar se vendi ynë ka provuar të jetë një aleat i besueshëm Euro-Atlantik. Kablaj tha se Turqia është e angazhuar për forcimin e lidhjeve miqësore dhe përmirësimin e bashkëpunimit mbrojtës me Malin e Zi dhe se Republika e Turqisë është e gatshme të konsiderojë modalitete të reja për forcimin e këtyre marrëdhënieve. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë për Politikën e Mbrojtjes dhe Planifikimit, Gjeneral Majori Rajko Pesic,

gjithashtu i uroi kolonel Kablaj punë të suksesshme, duke konfirmuar angazhimin e tij për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit të mbrojtjes midis dy ministrive. Pesic gjithashtu falenderoi për dhurimin e pajisjeve mjekësore që Turqia dërgoi në prill të vitit 2020 në luftën kundër epidemisë COVID-19, duke theksuar se kjo, si donacionet e mëparshme, është një shprehje e solidaritetit

dhe mbështetjes miqësore të siguruar nga Turqi. Mali i Zi.

Në takime të ndara, kolonel Kablaj gjithashtu bisedoi me Drejtorin e Përgjithshëm të Drejtorisë për Logjistikë të Regjimentit Veljko Mališić, Drejtorin e Përgjithshëm të Drejtorisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Çështjet e Personelit dhe Statusit, Vesna Mijovina, Shefin e Shtabit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Malit të Zi, kolonel Aleksandar Pantović, si dhe Shefin e Drejtorisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Žana Špadijer.

MINISTRJA E MBROJTJES E MALIT TË ZI, OLIVERA INJAC

Përmirësohet korniza ligjore për prokurimet në siguri dhe mbrojtje

Ministrja e Mbrojtjes e Malit të Zi, Olivera Injac mori pjesë në hapjen e tryezës së rrumbullakët “Prokurimi në Sektorin e Sigurisë dhe Mbrojtjes: Rregullat e reja të lojës, problemet e vjetra”, organizuar nga Instituti Alternativ, mbajtur në Hotel “Hilton” në Podgoricë. Ministri Injac theksoi se kjo temë është jashtëzakonisht e rëndësishme në këtë moment, veçanërisht duke pasur parasysh proceset e demokratizimit të sistemit të mbrojtjes, të cilat duhet të përmirësohen në një kohë rekord. Këto procese reformash janë me rëndësi të madhe për Malin e Zi si një anëtar i NATO-s, duke pasur parasysh ngjercin e identifikuar në sigurinë dhe prokurimin e mbrojtjes. Injac deklaroi se, si dikush që vjen nga komuniteti akademik, ajo e njeh rëndësinë e shoqërisë

civile dhe të gjitha shoqatave profesionale që merren me tema të tilla, dhe të cilat me siguri do të kenë një partner të mirë në Ministrinë e Mbrojtjes, të gatshëm për të njohur rëndësinë dhe përparësitë e një pune të tillë, në një qasje shumë më të qëndrueshme dhe të konsoliduar kur bëhet fjalë për politikat publike.

“Nevojat e Ministrisë për prokurim ishin dhe do të jenë të mëdha, veçanërisht pasi ne vërtet qëndrojmë në favor të modernizimit të ushtrisë malazeze, dhe kjo është një nga përparësitë e punës sonë. Thelbi është se ato fonde të konsiderueshme që janë zgjedhur për pajisjen duhet të jenë nën mbikëqyrje shumë më të madhe”, tha Injac.


Qëllimi kryesor, siç tha ajo, është përmirësimi i kornizës normative-ligjore në fushën e prokurimit në sektorin

e sigurisë dhe mbrojtjes. Përveç kësaj, ajo theksoi se pohimi i parimit të transparencës në punë është i nevojshëm. Gjithashtu, është e nevojshme të vihet theksi në politikën e integritetit, përmes një qasjeje proaktive, që do të thotë se do të bëhet një nga politikat kryesore të Ministrisë së Mbrojtjes dhe institucioneve të tjera në sektorin e sigurisë, në mënyrë që të eliminohen të gjitha rreziqet e korrupsionit, tha Injac. Ajo konkludoi se do të pritet harmonizimi i rregulloreve ligjore me normat e BE-së, por edhe me praktikatat pozitive në fushën e prokurimit të anëtarëve të tjerë të NATO-s. “Unë dua të krijoj mjedisin më të mirë të mundshëm në Malin e Zi, me angazhimin e përbashkët të të gjithë aktorëve për zbatimin e suksesshëm të këtij procesi”, tha ministrja Injac.

Ministrja Injac priti Gjeneral Majori Joseph Jarrard

SHBA janë aleati më i rëndësishëm strategjik i Malit të Zi

Pas largimit nga Tirana, Zëvendëskomandanti i Forcave Tokësore të SH.B.A.-së në Evropë dhe Afrikë (USAREUR), Gjeneral Majori Joseph Jarrard, ka vazhduar vizitat në rajon ku ka qëndruar më 4 shkurt 2021, në një vizitë pune në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ushtrinë e Malit të Zi. Me atë rast, Ministrja e Mbrojtjes Olivera Injac, dhe ushtrues detyre Zëvendës Shefi i Shtabit të Ushtrisë së Malit të Zi, kolonel Aleksandar Pantović, zhvilluan një takim pune me gjeneralmajor Joseph Gerard, gjatë së cilës u konkludua se bashkëpunimi dypalësh i mbrojtjes midis Malit të Zi dhe Shteteve të Bashkuara po vazhdon me një ritëm të kënaqshëm. Takimi u ndoq gjithashtu nga Ambasadorja e SHBA, Judy Rising Reinke. Ministrja Injac theksoi faktin se Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë aleati më i rëndësishëm strategjik i Malit të Zi në fushën e mbrojtjes dhe shprehu mirënjohje për mbështetjen e përgjithshme për përparimin e Ushtrisë së Malit të Zi. Duke shprehur angazhimin e plotë të Ministrisë së Mbrojtjes për projektet aktuale në fushën e modernizimit të sistemit të mbrojtjes malazeze, Injac shprehu kënaqësinë me projekte bilaterale të rëndësishme dhe të larmishme me Shtetet e Bashkuara në lidhje me trajnimin dhe stërvitjet e përbashkëta, forcimin e ndërveprimit të forcave të armatosura dhe trajnimin e personelit ushtarak. Ministri Injac theksoi angazhimin e Malit të Zi për politikën e Aleancës, përmes kontributeve aktive në sistemin e sigurisë kolektive, por gjithashtu për stabilitetin dhe prosperitetin e Ballkanit Perëndimor, duke nxitur marrëdhënie të fqinjësisë së mirë dhe duke bërë përparim brenda qëllimeve të politikës së jashtme - më i rëndësishmi prej të cilëve është Anëtarësimi në BE. Zëvendës Komandanti Gjeneral Major Joseph Jarrard theksoi se forcat tokësore të SHBA në Evropë dhe Afrikë do të vazhdojnë të mbështesin Ushtrinë e Malit të Zi në fushën e përmirësimit të kapacitetit dhe aftësive të Ushtrisë Malazeze, si dhe brenda planeve dhe përparësive për modernizimin e saj të mëtejshëm. Gjeneral Majori Jarrard theksoi se reformat e zbatuara mirë në sektorin e mbrojtjes rekomandojnë Malin e Zi si një aleat të rëndësishëm që kontribuon në mënyrë aktive në përpjekjet e Aleancës në fushën e parashikimit të stabilitetit dhe Ushtrinë e saj si një shumë profesionale. Gjatë vizitës, u prezantuan aftësitë e automjeteve të blinduara të lehta OSHKOSH, të cilat përfaqësojnë prokurimin më të rëndësishëm në bashkëpunimin dypalësh me Shtetet e Bashkuara, veçanërisht duke pasur parasysh se Mali i Zi është vendi i parë në Evropë që prokuron automjete të gjeneratës më të përparuar. Gjithashtu, përfaqësuesit e Ushtrisë së Malit të Zi mbajtën një prezantim për delegacionin e Ushtrisë Amerikane në Evropë dhe Afrikë, gjatë së cilës u prezantuan planet aktuale për zhvillimin dhe arrijten e qëllimeve të aftësive.



Mbajtja dhe ngritja e vazhdueshme e nivelit të fluturimit dhe trajnimit metodologjik të stafit komandues dhe udhëzues është një nga përparësitë në aktivitetet e bazës stërvitore. Klasat zhvillohen për të rritur kualifikimin e klasës për caktimin e specialitetit të klasës “pilot-pilot klasi i parë”, si dhe për pranimin në punën e instruktorit në avionin “Pilatus” RS-9M. Ndërkohë vazhdon kursi i trajnimit për avionët L-39ZA.



Shkolla e Lartë e Forcave Ajrore “Georgi Benkovski”

Në bazën ajrore “Dolna Mitropolia” fillon aktiviteti fluturues

Fluturimet kryhen në dy ndërrime fluturimesh me dy llojet e avionëve që janë në shërbim në bazën ajrore “Pilatus” RS-9M dhe L-39ZA



trajnimit gjatë ditës në kushte të thjeshta dhe komplekse të motit, trajnimi i tyre vazhdon në një nivel gjithnjë e më të lartë. Nga mesi i janarit, ata filluan të fluturonin me

L-39ZA për të zotëruar trajnimin natën në kushte të thjeshta të motit. Ndërsa vazhdon trajnimi i pilotëve të rinj në kuadër të programit për “Pilatus” RS-9M.

TRAJNIMI I INTELIGJENCËS NË TERREN

Stërvitje e përbashkët bullgaro - amerikane në “Batmish” dhe “Kamen”

Këtë javë u zhvillua stërvitja bullgaro-amerikane në fushën e inteligjencës në Qendrën e Trajnimit Specialist (CPS) në Sliven të bullgarisë. Në stërvitje mori pjesë një tog zbulimi e Batalionit 61 të Tankeve nën komandën e Kapitenit Vladimir Delchev dhe njësisë e Togës së Zbulimit të Batalionit të Dytë të Regjimentit të Pestë të Kalorësisë të Shteteve të Bashkuara, të drejtuar nga Rreshteri i Klasit të Parë Brian Meford. Stërvitja e përbashkët u organizua dhe drejtua nga Nënkolonel Evtim Maximov, Komandant i Batalionit 61 të Tankeve të Komandës Qendrore me Komandant Kolonel Lyubomir Vachev.

Efektivët bullgarë dhe amerikanë formuan ekupe të përziera dhe zhvilluan stërvitje me detyra orientimi dhe studimi për zonën në hartë, maskimin, vëzhgimin, pritën, mbijetesën në kushte të vështira, etj. Objektivat e trajnimit kishin të bënin me shkëmbimin e përvojës dhe njohurive, përmirësimin e komunikimit të ndërsjellë, përvetësimin e aftësive të reja dhe pajtueshmërinë midis dy vendeve në zbatimin e detyrave në lidhje me aktivitetet e tyre si inteligjencë ushtarake. Klasat e zhvilluan trajnimin në kompleksin e zjarrit “Batmish” dhe në rajonin “Kamen”. Krahas stërvitjes së përbashkët, ushtarët amerikanë gjatë qëndrimit në bullgari kanë vizituar gjithashtu monumentet historike të Sliven dhe u njohën me momente të historisë së vendit.

Bullgari-SHBA: Bashkëpunimi dypalësh në fushën e mbrojtjes

Zhvillimi i bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes midis Bullgarisë dhe Shteteve të Bashkuara u diskutua në 4 shkurt, në një bisedë telefonike nga Zëvendës Ministri i Mbrojtjes Atanas Zapryanov dhe Ushtruesi i Detyrës Zëvendës Ndihmës Sekretari i Mbrojtjes Andrew Winternitz. Gjatë bisedimeve, të dy përfaqësuesit ripohuan dëshirën e tyre për të vazhduar zhvillimin dhe thellimin e Dialogut Strategjik midis Republikës së Bullgarisë dhe Shteteve të Bashkuara në fushën e mbrojtjes.

Zëvendës Ministri i Mbrojtjes Atanas Zapryanov vuri në dukje se përpjekjet e vazhdueshme për të zgjeruar dhe azhurnuar iniciativat e kryera në bazë të “Marrëveshjes për Bashkëpunim Mbrojtës midis Qeverisë së Republikës së Bullgarisë dhe Qeverisë së SHBA” pavarësisht krizës



globale të shkaktuar nga përhapja e COVID-19, janë një sinjal i qartë i angazhimit që të dy vendet ndajnë në lidhje me ndërtimin e një bashkëpunimi afatgjatë dhe të frytshëm në fushën e mbrojtjes. U evidentura suksesi i arritur me nënshkrimin më 6 tetor 2020 nga Ministrat e Mbrojtjes të të dy vendeve të “Udhërrëfyesit për Bashkëpunim Mbrojtës midis Republikës së Bullgarisë dhe Shteteve të Bashkuara 2020-2030”. Në këtë kontekst, u diskutuan mundësitë për modernizimin dhe rritjen e ndërveprimit të Forcave të Armatosura Bullgare, si dhe për zgjerimin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë kibernetike.

Andrew Winternitz ripohoi gatishmërinë e Shteteve të Bashkuara për modernizimin e Forcave të Armatosura të Bullgarisë. Ai vuri në dukje dhe shprehu mirënjohje për angazhimin e vazhdueshëm të Republikës së Bullgarisë në misionet dhe operacionet e NATO-s, duke përfshirë pjesëmarrjen e vendit në misionin e NATO-s në Afganistan “Mbështetje të Vërtetë”, si dhe ndarjen e përgjegjësisë financiare në Aleancë.

Në fund të bisedës, u shpreh edhe një herë gatishmëria dhe dëshira e të dy palëve për të vazhduar punën me administratën e Presidentit të SHBA Joe Biden, për të zgjeruar dhe thelluar partneritetin strategjik në mbrojtje, përfshirë fushën e sigurisë kibernetike dhe rajonin e Detit të Zi.

Skënderbeu në fasadën e Shtëpisë së Artë në Gdansk

Grafika që përshkruan
Skënderbeun në Gdansk

“Shtëpia e Artë” (Złota Kamienica) është një nga godinat më të bukura të qytetit port Gdansk, në Poloni dhe ka një histori të gjatë dhe interesante. Në fasadën e saj qëndron dhe portreti i Heroit Kombëtar të Shqipërisë, Gjergj Kastrioti Skënderbeu.

Sipas mediave polake, ndërtimi i Shtëpisë së Artë nisi në vitin 1609, me urdhër të pronarit të atëhershëm Johann Speimann, më vonë kryetari i Gdansk. Blloku i banesave është projektuar nga Abraham van den Blocke, përfaqësues i shquar i manierizmit holandez bashkë me babain e tij Vilhelm, një nga arkitektët më të respektuar të epokës. Këto punime përfunduan në vitin 1618 dhe shumë shpejt mori funksionin e një muzeu specifik, duke u dhënë mundësi vizitorëve të shohin pikturat e pasura, artizanatit dhe koleksionet ushtarake të mbledhura prej Speimann.

Gjatë shekujve të mëvonshëm u bë një bankë, që gjatë periudhës së qytetit të lirë në Gdansk dhe në 1938 u bë selia e Muzeut Krahinor të Prusisë Perëndimore, institucion që merret me koleksione natyrore dhe arkeologjike. U shkatërrua bashkë me pjesën më të madhe të qytetit në mars të 1945 dhe u rindërtua me përpikmëri pas luftës. Që nga viti 1952 është selia e Institutit Detar të Universitetit detar Gdynia.

Fasada është elementi më përfaqësues i saj, dhe katet që janë zbukuruar me figura që u referohen virtyteve qytetare dhe komandantëve të shquar, si antikë dhe modernë.

Por figura e Skënderbeut nuk është një figurë në hapësirën historike të Gdansk, por pse gjendet në fasadë?

**Gdanku lirishtës
e vlerësoi Skënderbeun**

Vlerat që i atribuohen Skënderbeut gjeten një tokë pjellore në komunitetin e pavarur të klasës së mesme të Gdanskut modern. Nga mediat polake figura e Skënderbeut konsiderohet mjaft e afërt me vlerat e banorëve të Gdansk, dashurinë për lirinë e çmuar.

Deri në vitin 1945, viti 1609 ka qënë vendosur në një glob që ndodhej poshtë këmbës së statujës së Perëndeshës së Fatit “FATUM”, të vendosur në majën e kulmit të çatisë së godinës. Pas shkatërrimit të kësaj godine, në vitin 1945, gjatë bombardimeve të Ushtrisë së Kuqe, në kuadër të luftimeve të Luftës së II-të Botërore, pas rikonstruksionit të saj në vitin 1952, viti 1609 nuk është vendosur përsëri në këtë godinë. Ndërtuesi i saj ishte Kryetari i Bashkisë së Gdanskut të asaj kohe, Jan Speyman, një jurist gjerman dhe koleksionist i veprave të artit. Godina ishte projektuar nga arkitekti Holandez Abraham van den Blocke. Gjatë katër shekujve të egzistencës së saj, kjo godinë ka pësuar dëmtime të shumta ku më të rëndat kanë qënë ato të vitit 1813, gjatë marshimit të reparteve ushtarake të Napoeon Bonapartit drejt Moskës dhe ato të vitit 1945, kur godina u shkatërrua plotësisht nga bombardimet e Ushtrisë së Kuqe të Bashkimit Sovjetik. Sot godina është pronë e Institutit të Detarisë të Polonisë dhe, përveç zyrave të tij, aty është vendosur edhe biblioteka e Jan Speymanit dhe një Galeri Arti.

Lidhjet e para midis Shqipërisë dhe Polonisë datojnë që në vitin 1443, para betejës së Nishit, kur Skënderbeu është takuar në Budë të Hungarisë me mbretin polak Vlladisllavi III. Sipas historiografisë polake, në vitin 1446 u vendosën marrëdhëniet e drejtpërdrejta diplomatike midis Shtetit shqiptar të Skënderbeut dhe Mbretërisë Polake



Në fasadën e Godinës së Artë, në katër kollonat e çdo kati si dhe në hapësirat midis kollonave, janë vendosur 30 skulptura, buste dhe basorelieve të personaliteteve nga më të shquarat të historisë së njerëzimit, nga lashtësia e deri në shekullin XVI. Përzgjedhja e tyre është ndarë në katër grupe: në personalitetet që kanë atributet e virtyteve të Zgjuarsisë, Drejtësisë, Mëshirës dhe Maturisë. Ato personifikohen me simbole kafshësh dhe konkretisht: Zgjuarsia me simbolin e kaprollit dhe bririt, Drejtësia me simbolin e luanit dhe librit, Mëshira me simbolin e dashit dhe kokës njerëzore dhe Maturia me simbolin e demit dhe kokës së qenit.

Mbështetur në këto kritere, përzgjedhja e personaliteteve është bërë si më poshtë: në majë të Godinës është vendosur statuja e Perëndisë së Fatit-Fatum; në rreshtin 2 janë vendosur, nga e majta në të djathtë statujat e Kleopatrë-s, Edipi-t, Akili-t dhe Antigonë-s; në rreshtin 3 janë vendosur bustet e Kanton-it, Scypion-it, Kato Juniorit dhe Solon-it; në rreshtin katër janë vendosur simbolet e virtyteve të Zgjuarsisë, Drejtësisë, Heroizmit dhe Burrësisë, si dhe Maturisë.

Në hapësirën midis kollonave alegorike të Drejtësisë dhe Burrësisë nga lart poshtë

janë vendosur basorelievet e: Në katin e tretë basorelievi i Skënderbeut

me atë të hungarezit Janosh Hunniadi. Basorelievi paraqet dy kalorës autentikë, Gjergj Kastriot Skënderbeu-n dhe Janosh Hunniadi-n. Në sfond paraqitet kalorësia turke duke u tërhequr në formë gjysmë rrethi, që ishte karakteristike e betejave të saj. Ajo përdorte një taktikë specifike gjatë luftimeve, bënte sikur tërhiqej nga luftimi dhe pastaj, papritur rikthehej në fushën e betejës, duke sulmuar repartet e ushtrive kundërshtarë. Dy heronjtë në kuaj janë luftëtarë të shquar në betejat kundër hordhive turke: Skënderbeu (1405-1469), princi shqiptar, i cili për 25 vjet zmbropsi me sukses sulmet e ushtrive turke dhe Janosh Haunniadi (1385-1456) vojevoda e Siedmoigrodit, që mori pjesë në betejën e Varnës në vitin 1444, bashkë me mbretin polak Vlladisllavi III, që e humbën këtë betejë, por pastaj Hunniadi fitoi mbi ushtritë turke në afërsi të Beogradit. Sukseset e tij zmbropsën për një farë kohe kërcënimin turk.

Vlerësimi dhe rëndësia e vendosjes së basorelievit të Skënderbeut në “Shtëpia e Artë” (Złota Kamienica) del më në pah kur mëson për bustet apo basorelievet e personaliteteve historike botërore që kanë zënë vend aty si: busti i Solonit (635-560 p.e.s.)-një ndër 7 njerëzit më të mençur të lashtësisë, busti i Kato Junior (Marcuc Porcius Cato

Utincensis-95-46 p.e.s.)-personalitet i shquar i mbrojtjes së Republikës Romake, busti i Medyceus-it (De’ Medici-1449-1492)-nën sundimit të tij Firenze arriti madhësinë, busti i Cato Senjior Cenzor (Marcus Porcius Cato Maior Censorius-rreth viteve 234-149 p.e.s.)-personalitet i shquar i mbrojtjes së Republikës Romake, vendosi për herë të parë në Romë taksën mbi pronën, themelues i prozës letare latine, busti i Otto III-perandor gjerman, busti i Zigmunt III Waza-1566-1632-mbret polak i cili në vitin 1612 pushtoi Moskën, busti i Scipion Junior Afrikanasi-t (Publius Cornelius Aemilianus Afrikanus Minor, Numantus 185-129 p.e.s.), komandant i shquar ushtarak që në vitin 146 p.e.s. pushtoi Kartagjenën gjatë luftës III punike; busti i Vlladisllav Jagiello-s -1351-1434. Mbret i Polonisë dhe Princi i Madh i Lituaniës, që në ato vite ishin shtete në Union me njeri tjetrin; busti i Henrik-ut IV-1553-1610, themelues i dinastisë së shquar franceze të Burbonëve; busti i Caius Fabricius Lusinus-jetoi midis shekujve IV/III p.e.s. udhëheqës Romak që shquhej për ndershmëri dhe ruajtjen me rigorozitet të traditave romake. Gjatë luftës së Romës me Pirron e Epirit në vitin 282 p.e.s. u dërgua në kampin e Pirros për të biseduar lidhur me shkëmbimin e robërve. Pirro-ja u përpoq ta blinte Fabricius-in me arka me flori dhe gurë të çmuar. Kur kjo nuk dha rezultat, u përpoq ta trembë, duke i dërguar në çadër një elefant të madh për ta shtypur. Të dy këto përpjekje nuk dhanë rezultate. Në vitin 278 Fabriciusi i dërgoi Pirros mjekun e tij, i cili në shkëmbim të një shpërblimi të madh në para, pranoi ta helmonte atë. Por, duke parë fisnikërinë e Fabricius-sit, Pirro-ja u detyrua të tërhiqej nga Italia; basorelievi i Themistokli-ut i cili jetoi rreth viteve 524-459, politikan dhe burrë shteti i Greqisë së lashtëi cili forcoi shumë flotën greke tregtare dhe atë ushtarake, e cila luajti një rol të rëndësishëm në shpartallimin e ushtrive Perse të Kserksit në vitin 480 p.e.s. në afërsi të Salaminës; basorelievi i Lucius Junius Brutus -85-42 p.e.s.; basorelievi i hebreut Maccabeus-it, bir i Matatias, vdekur në vitin 160 p.e.s., i cili udhëhoqi kryengritjen e hebrevje kundër dinastisë të Seleucidëve, për të përfshirë kultet pagane në faltoret e Jerozolimës dhe duke fituar kryengritjen, ktheu kul-

tin e Jehovahit; basorelievi i Camillus (Marcus Furius Camillus), udhëheqës dhe politikan i shquar Romak, i cili mundi Galët që në vitin 340 p.e.s. të cilët kishin shkatërruar Romën dhe pas kësaj filloi me rindërtimin e saj, duke u mbiquajtur “pater patriae” (at i atdheut), duke u bërë kështu themeluesi i dytë i Romës, etj. dhe figura të tjera të mëdha historike.

Nga përshkrimi më lart i statujave, busteve dhe basorelievet që përmbahen në fasadën e “Godinës së Artë”, rezulton se, përveç basorelievit të Skënderbeut që është i lidhur drejtpërdrejt me historinë e Shqipërisë, ishte edhe busti i Caius Fabricius Lusinnus-it që lidhet me luftrat e Pirros së Epirit në Itali në vitin 278 p.e.s. që u përmend më lart. Vendosija e basorelievit të Skënderbeut në “Godinën e Artë” të Gdanskut lidhet me popullaritetin e madh që gëzonte figura e tij në Poloni. Lidhjet e para midis Shqipërisë dhe Polonisë datojnë që në vitin 1443, para betejës së Nishit, kur Skënderbeu është takuar fshehurazi në Budë me mbretin polak Vlladisllavi i III-të dhe me Janosh Hunniadin, mbreti regjent hungarez dhe vojevoda i Transilvanisë. Në ato vite Polonia me Hungarinë bënë pjesë në një shtet të përbashkët dhe kishin formuar Unionin Polako-Hungarez. Simbas historiografisë polake, në vitin 1446 u vendosën marrëdhëniet e drejtpërdrejta diplomatike midis Shtetit Shqiptar të Skënderbeut dhe Mbretërisë Polake. Basorelievi i Skënderbeut në fasadën e “Godinës së Artë” në Gdansk ka rëndësi të veçantë, sepse është i vetmi basoreliev për Heroin tonë Kombëtar që është gjetur deri tani i ekspozuar në Europë. Në shumë vende të ndryshme të Europës, në SHBA dhe në kontinente të tjera janë shkruar shumë vepra letrare, në poezi, prozë, dramaturgjii, opera, etj. si dhe janë ngritur shumë monumente dhe buste, por basoreliev është gjetur vetëm një, ai i vendosur në fasadën e “Godinës së Artë” në Gdansk të Polonisë. Për këtë, studiuesi i mirënjohur Prof. Ferid Hudhri, në Enciklopedinë “Shqiptarët në Artin Botëror”, faqe 379, shkruan: “Në portin verior të Europës, në qytetin Gdansk të Polonisë, ndodhet një vepër tjetër e veçantë për llojin e saj. Gjergji [Skënderbeu] këtu është gdhendur në reliev. Midis gjithë veprave më të hershme, kjo është e vetmja e këtij lloji nga sa njohim deri tani”. Përfshirja e basorelievit të Skënderbeut ndër 30 statujat, bustet dhe basorelievet e personaliteteve më të shquara në fasadën e Godinës së Artë në Gdansk, merr edhe një rëndësi tjetër të veçantë, sepse kjo Godinë, me një numër kaq të madh veprash arti, është nga më të rrallat dhe ndoshta e vetmja në Botë që ka një profil të tillë. Veprat e Gjergj Kastriotit Skënderbeut dhe rezistenca e tij ndaj pushtesit turk u bë e njohur në të gjithë Europën dhe në shekujt e ardhshëm mbijetoi falë biografisë së Marin Barletit.



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Rrënjët e familjes Kuka

Oso Kuka i njohur, quhej Osman Bejtullah agëKuka dhe ka lindur në Shkodër, rreth vitit 1820 në një familje kalorësish me origjinë të hershme nga Kukësi. Shtëpia e Kukajve bëhet e njohur me Ibrahim Kukën, gjyshin e Osos, i cili më 1802 pajiset me një timar për shërbimet ushtarake, të ardhurat e të cilit i nxirrte në natyrë nga fshatarët e katundeve Mes, Egërç, Lopç të Rranxave të Mbishkodrës. Në bazë të dekreteve sulltanore, Ibrahim emërohet qehaja i kalasë, gradë që krahasohej me ndihmës-komandant ose intendent. Bejtullah agë Kuka, ishte ndër oborrtarët e Vezirit Mustafa Pashës. Të dhënat popullore tregojnë se vezirët Bushatlinj, Kukajt i kanë mbajtur për bajraktarë të vet. Jusuf agë Kuka i dytë, vëllai i Osos, ishte në njësinë administrative të vilajetit të Shkodrës më 1897, figuron se ka qenë komandant kompanie i maleve Reç e Lohe. Me vdekjen e Ibrahimit, timari i lartpërmendur më 1815 kaloi në emër të birit, Jusuf agë Kukës, i cili gëzoi edhe gradën qehaja për rezervistët që shërbenin në kala.


Oso rininë e tij, për 27 vite, e kaloi rrugëve të kurbetit në Anadoll, në Tarabulluz, në Halep e mandej edhe nëpër Rumeli. Së fundi përshkoi Dibrën dhe disa vise të tjera shqiptare. Më 1859 Oso mori gradën kapiten, dhe u caktua me detyrë komandant i rojeve kufitare në kohën e valiut Abdi pashë Çekrezi. Kjo detyrë iu ngarkua me propozimin e Hodo Sokolit, në atë kohë komandant xhandarmërie, duke u caktuar kapiten i rojeve në kufirin osmano-malazez, në ishullin e Vraninës, në veri të liqenit të Shkodrës.

Lufta e Vraninës

Shqiptarët në shek. XIX u gjendën si asnjëherë tjetër në mes dy zjarresh: nga një anë perandoria pushtuese otomane dhe nga ana tjetër rizgjimi i lakmive grabitqare të fqinjëve sllavë. Perandoria Otomane në shek. XIX në fakt ishte futur në krizë, pasi kishin filluar luftërat çlirimtare të popujve që kërkonin lirinë, por dhe të fuqive europiane që përbënin gjithmonë një rrezik të përhershëm për shembjen e saj. Rusia, po bëhej mbështetje për vëllezërit sllavë të Ballkanit. Fqinjët e shqiptarëve, kërkonin të zgjerohin territoret e tyre nga pjesa e Perandorisë otomane europiane. Këto territore ishin troje të Shqipërisë etnike. Kështu malazezët fqinjë kërkuar të përfitojnë nga trevat e Shqipërisë Veriore e Veriperëndimore.

Në qershor të vitit 1862 malazezët drejtuan ushtrinë në ishullit strategjik e të mrekullueshëm të Vraninës. Përgatitjet ushtarake dhe ndihmat nga Rusia kishin përfunduar me kohë dhe duhej shkaku për të sulmuar mbi Vraninë.

Shkaku u gjet, për disa ushtarë të Oso Kukës u bë ankesë nga ana e Liubotinasve se kur kalonin gratë rrugës u merrnin peshqeshet, kur ktheheshin në shtëpitë e veta. Kjo vepër e shqiptarëve për burrat e këtyre familjeve konsiderohej çështje nderi... Malazezët



kishin si qëllim kryesor pushtimin e Vraninës. Ishulli i Vraninës ishte i ndarë krejt prej Shkodre. Dokumentet e kohës thonë se Oso Kuka ishte komandant i rojeve kufitare. Për ankesën e Liubotinasve kishte marrë masat e nevojshme, ndonëse ky kishte qenë “improvizim” i malazezëve. Kështu malazezët filluan plaçkitjet dhe raprezaljet mbi popullsinë e Vraninës.

Rojet kufitare dhe vendasit e kishin të pamundur të përballojnë cubat dhe ushtarët malazezë. Avdi Pasha, që ishte sundimtari i Shkodrës e nip i derës së Karageorgjeviçëve të Beogradit, nuk dërgoi ushtarë të Perandorisë për të mbrojtur Vraninën. Thërret në Shkodër Oso Kukën ku i thotë se malazezët me në krye Vullo Serdarin në Vraninë po vrasin, presin e bëjnë kerdinë. Nuk paska asnjë shqiptar që të shkojë për t'i dalë zot këtij vendi. “Situatën” dramatike mes komandantit trim shqiptar Oso Kukës dhe Avdi Pashës, sundimtarit të Shkodrës, e përshkruan mjaft mirë At Gjergj Fishta në “Lahuta e Malësisë”,

Oso Kuka zgjodhi luftëtarët më të mirë nga Shkodra, Mirdita, Dukagjini e veçanërisht nga Malësia e Madhe, por dhe nga Jugu i Shqipërisë krijoi çetën me 40 vetë. At Gjergj Fishta këndon për këta trima që po shkonin drejt Vraninës, që i priste lufta e vdekja dhe jo dasma. Të gjithë trimat që u nisën për Vraninë ishin luftëtarët më të zgjedhur të cilët do të justifikonin para atdheut detyrën e shenjtë në mbrojtje të truallit të Shqipërisë etnike, dhe konkretisht të Vraninës historike... Në këtë luftë morën pjesë dhe luftëtarë nga krahinat e Shqipërisë, ku tregohet trimëria e malësorëve të Hotit e Grudës në muajin maj (1862) të cilët kishin arritur të prisnin 30 koka të armiqve dhe i prunë në Shkodër, si shenjë trimërie e qëndrese në mbrojtje të trojeve shqiptare.

Mali i Zi ishte tashmë shtet, Turqia i kishte njohur pavarësinë. Vëllezërit serb dhe rusë ju gjendën pranë për synimet grabitqare. Mali i Zi kishte një ushtri të organizuar në numër të konsiderueshëm dhe një teknikë luftar-

ake moderne për kohën. Shqiptarët u organizuan vetë në luftë sepse shteti turk më shumë i pengonte se i ndihmonte. Elementi që organizoi shqiptarët ishte atdhedashuria, amaneti i të parëve për liri e pavarësi.

Zhvillimi i luftimeve

Megjithë qëndresën heroike të shqiptarëve, Vranina po rrezikohej të



binte në duart e malazezëve. Në këto momente luftarake trimi Oso Kuka, së bashku me rreth 30 burra ishin pozicionuar në mbrojtje dhe kishin hyrë në kullën e barotit. Kulla u gjend e rrethuar me rreth 3.000 ushtarë e oficerë malazezë. Në krye të ushtrisë ishte vetë princ Kral Nikolla. Lufta u zhvillua e ashpër në mes qëndrestarëve, pra luftëtarëve të rrethuar shqiptarë dhe malazezëve, të cilët u bënë thirrje të dorëzoheshin. Luftëtarët shqiptarë me në krye Oso Kukën, po luftonin si luanë malesh, në çdo frëngji, në çdo bedenë dhe në çdo cep të kullës. Oso Kuka, edhe pse i plagosur, qëndronte në këmbë dhe u jepte kurajo luftëtarëve trima që tashmë i priste vdekja e sigurtë.

Pas shumë përpjekjesh për të

marrë kullën, ushtria malazeze kishte dështuar. Luftëtarëve po ju mbaronte dhe municioni. Ndërsa luftimi trup më trup ishte i pamundur, sepse po të dorëzohej kulla, luftëtarët shqiptarë ishin të asgjësuar prej ushtrisë malazeze. Oso Kuka ju bëri thirrje luftëtarëve për të mos u dorëzuar, por për të hedhur në erë kullën. Kështu të gjithë bashkë vendosën të hedhin në erë kullën e barotit, ku do hidhte në

shpërndarë në truall të Vraninës dhe në ujërat e liqenit. Thuhet se shtëllunga e tymit dhe e flakës u pa deri në sarajet e Cetinës dhe të Shkodrës. Shpërthimi u dëgjua edhe më larg deri tek pallatet e kralnive të Europës plakë, duke u treguar se trojet shqiptare kanë zot, që nuk i lëshon deri sa mbi to të kenë këmbë shqiptari.

Oso Kuka dhe luftëtarët e tij, me këtë akt vetflijues i treguan ushtrisë së Malit të Zi se trojet shqiptare nuk kanë mbetur as nuk do të mbesin kurrë pa djem në vatrën shqiptare që do t'u dalë përzot, ndaj At Gjergj Fishta vargëzon fjalët kushtrim të trimit Oso Kuka: “Eni, eni more shkina,/ Eni, eni te Vranina...”

Pavdekshmëria e heronjve legjendarë të Vraninës

Oso Kuka së bashku me luftëtarët e tij, ku kishte dhe nipin Salë Behri, të riun 16 vjeçar, si dhe luftëtarët: Musa Golemi, Met Begoja, Ibrahim Kopliku, Pjetër Berisha, Jusuf Bushati, Met Mala, Sadik Lapi, Myrto Zylfoja, Ferid Hoti, Sali Sakica, Sinan Kerni, Gjergj Cemi (Grudjani), Avdi Hisa, Taro Pëllumbi, Mahmut Zyberi, Met Zeneli, Vuksan Gjeli, Gjeto Gruda, Mal Spahia, Galo Keqi, Çok Mark Kola (Dini), Preng Markola, Sokol Tona dhe dy “retë mizore” prej Zagore (Malësisë së Madhe), Kaçel Doda, Kerni Gila, Mahmud Zyberi dhe të tjerëve nuk iu dihen emrat, tre a katër prej këtyre të fundit ishin nga Jugu i Shqipërisë, ndërsa Pjetri ishte shërbëtor i Osos.

Emrat e luftëtarëve dëshmorë të pa harruar janë siguruar nga disa materiale historike të librit “Shkodra dhe Motet”, v. I, të H. Bushatit, “Oso Kuka”, të S. Krasniqit (roman historik), “Lahuta e Malësisë” të At Gj. Fishtës, Fletë të regjistrave të famullisë Shkrelit (Bzhëte), si dhe gojëdhënat që qarkullojnë edhe sot në Malësi e në Mal të Zi.

Për heroizmin e tij, Oso Kukës iu kushtuan këngë popullore. Kështu në vitin 1898 në gazetën e “La Nazione Albanese” të Anselmo Lorekios; Kasem Taipi te “Zane popullore” dhe Hamdi Bushati te “Shkodra dhe motet”. Portretizi me rëndësi i është bërë nga Gjergj Fishta në veprën epike “Lahuta e Malsisë”, ku përshkruhet lufta e Oso Kukës dhe rënia e tij në “ciklin e Oso Kukës” me 5 këngë. Në këngën popullore të njohur Oso Kuka e quan veten Shkodran, por poeti te Lahuta e paraqet si hero që i krenohet Knjazit porsi shqiptar.

Për Oso Kukën kanë shkruar dhe folur: G. Meyer shkroi në Albanische Forschungen më 1897. Ndërsa më 1921 Zef Mark Harapi shkroi dramën “Trimnija e Oso Kukës”, e cila u vendos në skenë nga aktorët amatorë të shoqërisë kulturore “Bogdani” në Shkodër.

Më 1923 Avni Rustemi përmend emrin e Oso Kukës në një thirrje që u drejton autorëve të shoqërisë “Bashkimi”. Shkrimtari Sulejman Krasniqi ka shkruar romanin historik “Oso Kuka” në vitet 1990. Malazezët vendin e hedhur në erë e identifikojnë kulla e Oso Kukës, ndërsa tek shtëpia e Kukajve në Shkodër është ngritur Muzeu historik i qytetit. Në Shkodër, për ndonjërin që nuk del nga shtëpia përdoret shprehja “asht ndry si Oso Kuka”.



TRE KURSE NË QENDRËN STËRVITORE TË FORCËS TOKËSORE

Kursi i oficerit në Këmbësori, Zbulim dhe i Avancuar i Nënoficerit

Në mjediset e Qendrës Stërvitore të Forcës Tokësore po zhvillohen kurset institucionale të oficerit në specialitetet Këmbësori dhe Zbulim, si dhe Kursi Bazë dhe i Avancuar i Nënoficerit. Kursi Bazë dhe Kursi i Avancuar i Nënoficerit, që kanë filluar në datën 25 janar 2021 kanë një program të shtrirë në një periudhë 8-javore. Në këto kurse zhvillohen temat mësimore në module teorike dhe praktike. Qëllimi i kurseve është përgatitja e nënoficerit për drejtimin e trupave në nivel skuadër dhe togë këmbësorie. Kursi Bazë i Oficerit është një nga kurset më të gjata që zhvillohen në Qendrën Stërvitore dhe zgjat 18 javë. Në këtë kurs trajtohen temat e lidhshme ushtarak, taktikë, alpinizëm, përgatitje fizike dhe zbulim. Qëllimi i Kursit Bazë të Oficerit është përgatitja e oficerit në rolin e komandantit të togës. Kurset institucionale shërbejnë për formimin ushtarak si dhe janë të rëndësishme pasi janë në funksion të marrjes së të gradës së radhës.

